



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

KESHILLI BASHKIAK

Nr 2776/Prot
11

B.Curri, me 9 . 7 . 2022

V E N D I M

Nr 43 Dt . 30.06 . 2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË TROPOJË, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR SHKOLLËN E MESME "MATOSH UKA" NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZE BASHKIA TROPOJE PËR DËMTIMET E SHKAKTURA NGA TERMETI I DATËS 10.04.2022

Këshilli i Bashkisë Tropojë, në mbledhjen e tij të datës 30.06. 2022, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1, shkronja "b", neni 23 pika 11, nenit 34 pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 "Per Vetqeverisjen Vendore"; Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; Ligjit nr. 45/2019, "Per Mbrojtjen Civile", Kreu I pika 1; Kreu III, neni 27 Shkronja "c", Neni 29 pika 2, Neni 30 shkronja "f"; Kreu IV Neni 40 Shkronja "a"; Kreu XI Neni 65 pika 1; Te VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 pika 3, shkronja "gj", "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmëve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; Vendimi nr.414 datë 8.7.2021 "Per miratimin e Procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile".VKM-ja nr.565,datë 22.8.2012 "Për Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Fierzë, të qarkut të kukësit", pasuria nr. 2/52 Zona Kadastrale 1617; Kërkeses te bërë nga drejtoresha e shkollës së Mesme "Matosh Uka" Njësia Administrative Fierze datë 11.04.2022; Shkresa e Bashkisë Tropojë nr. 1711 prot., datë 14.04.2022 "Kerkese për informacion mbi dëmtimet e disa shkollave në Bashkine Tropoje, si pasojë e termetit me date 10.4.2022", drejtuar AKMC-së; Shkresa nr. 1711/1 prot., datë 29.4.2022 "Kthim Përgjigje" e AKMC-së.

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Tropojë për përgaditjen e dokumentacionit për riparimin e shkollës së Mesme "MATOSH UKA" Njësia Administrative Fierze të dëmtuar nga tërmeti i datës 10.04.2022

2. Ti akordojë fondin prej 1 236 448 (njëmiljon e dyqinide tridhjetë e gjashtë mijë e katerqind e dyzet e tetë) për riparimin e kësaj shkolle të dëmtuar nga termeti i datës 10.04.2022.

3. Burimi i financimit është Fondi Emergjencës Civile të parashikuar në buxhetin e Bashkisë Tropojë për vitin 2022 miratuar me VKB , Nr.111 datë 24.12.2021, "Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë për vitin 2022."

4. Të miratojë dokumentacionin tekniko- ligjor të hartuar nga Bashkia Tropojë


5. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Finances.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Për Këshillin Bashkiak Tropojë

Sekretar

Ergent Gjongecaj



Shpallur me 04.07.2022
Miratuar me 15 vota
Vota Pro 15 vota
Vota Kunder 0 vota
Vota Abstenim 0 vota

Kryetar

Shotë Bashaj

